

VENDIM
Nr.28, datë 24.6.2005

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR
KOMPANINË PUBLIKE TË GJENERIMIT**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 28 pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike ”, Bordi i Komisionerëve të ERE–s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2005, pasi shqyrtoi draftin për metodologjinë e llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, të hartuar nga Task–Forca e ngritur dhe nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema